



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 36, datë 01/07/2004

**“PËR  
TRANSFERIMIN E AKTIVEVE TË QËNDRUESHME,  
QARKULLUESE, DHE DETYRIMEVE DEBITORE E KREDITORE TË  
ISH-QËNDRËS EKONOMIKE TË ARSIMIT DHE ISH-QËNDRËS  
EKONOMIKE TË ÇERDHEVE, SIPAS BILANCIT TË DATËS  
31/03/2004, NË QËNDRËN EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE  
EDUKIMIT TË FËMIJËVE DHE NE DREJTORINË NR.3 TË  
PUNËTORËVE TË QYTETIT TIRANË”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.7661, dt.19/01/1993 “Për kontabilitetin” (kapitulli “Rregullat e vlerësimit”), VKM Nr.248, dt.10/04/1998 “Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qëndrore e Lokale si dhe Njësive që varen prej tyre”, ligjit Nr.6942, dt.25/12/1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare”, VKM Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve buxhetore”, pika 2/ç, Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr.14, dt.10/03/2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të fëmijëve” dhe Nr.15, dt.10/03/2004 “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë transferimin kapital nga ish-Qendra Ekonomike e Arsimit në bilancin kontabël të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, Qarkulluese dhe Disponibiliteteve në Thesar në shumën prej **207.169.475** lekë sipas Shtojcës Nr.1 bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të miratojë kalimin e detyrimeve sipas bilancit kontabël të datës 31/03/2004 në shumën prej **79.320.776** lekësh sipas Shtojcës Nr.1/1, pjesë përbërëse e këtij vendimi, nga ish-Qendra Ekonomike e Arsimit në bilancin kontabël të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

3. Të miratojë transferimin kapital nga ish-Qendra Ekonomike e Çerdheve në bilancin kontabël të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe Aktiveve Qarkulluese në shumën prej **167.244.190** lekësh sipas Shtojcës Nr.2 bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë kalimin e detyrimeve sipas bilancit kontabël të datës 31/03/2004 në shumën prej **6.717.590** lekësh sipas Shtojcës Nr.2/1, pjesë përbërëse e këtij vendimi, nga ish-Qendra Ekonomike e Çerdheve në bilancin kontabël të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
5. Të miratojë transferimin kapital nga ish-Qendra Ekonomike e Arsimit në bilancin kontabël të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, Qarkulluese dhe Disponibiliteteve në Thesar në shumën prej **462.729.320** lekësh sipas Shtojcës Nr.3 bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve dhe Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**